



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/19), dhe nenti 40 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit nga parashtruesi ..... në vazhdim të seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020 morri:

### VENDIM

Procedura për lëndën me numrë 12-1222/1 me datë 19.02.2020 e formuar pas denoncimit nga parashtruesi ..... të dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën me numrë 12-1222/1 me datë 19.02.2020, për shkak se akuzat në denoncim nuk janë vërtetuar.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### Sqarim

Lënda me numër 12-1222/1 me datë 19.02.2020 është formuar mbi bazë të denoncimit të marrur nga parashtruesi .....

Në denoncim tregohet për akuza për akuza për dyshime joligjore dhe parregullësi në procedurën për punësim të tre ekzekutorëve në vendin e punës 1700/81 Operator të kondenzimit në Shërbimin për prodhim, Njësia prodhuese e Termoelektranes në filialën REK Oslomej – Oslomej të SHA ESM-Shkup, në bazë të thirrjes publike nr. 04-322/1 me datë 21.01.2020.

Me qëllim të kontrollimit të bazimit të akuzave dhe caktimit të gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve 12-1222/2 me datë 07.07.2020 me të cilën kërkon nga SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut filiala REK "Oslomej" në f. Oslomej të dorëzohet informacion të plotë për realizimin e procedurës të punësimit të tre ekzekutorëve në vendin e punës 1700/81 Operator të kondenzimit në Shërbimin e prodhimit, Njësia prodhuese Termoelektrana në filialën REK Oslomej – Oslomej të SHA ESM – Shkup, mbi bazë të shpalljes publike me numër 04-322/1 me datë 21.01.2020, me shtojcë dokumentacion (procesverbale, vendime dhe dokumente tjera relevante)

Nga SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut filiala REK "Oslomej" në f. Oslomej në afatin e caktuar me ligj është dorëzuar përgjigje për kërkesën e KSHPK.

Pas rishikimit të akuzave në denoncim dhe të dhënave të mbledhura nga institucione tjera relevante, KSHPK e vendosi këtë:

- Me datē 20.10.2020 ēshtē publikuar shpallje publike me numēr 04-322/2 me datē 20.01.2020 143/2019 pēr punēsim tē mē shumē ekzekutorēve nē mē tepēr vende tē punēs tē theksuara nē shpalljen publike mes tē tjerave edhe tre ekzekutorēve nē vendin e punē 1700/81 Operatorē tē kondenzimit nē Shērbimin pēr prodhim. Njēsia Prodhuese Termoelektrana nē filialēn REK Osllomej – Osllomej nē SHA ESM – Shkup
- Nē thirrjen publike pēr vendin e theksuar tē punēs kērkohen tre ekzekutor nē vendin e punēs 1700/81 Operator tē kondenzimit nē Shērbimin pēr prodhim, Njēsia prodhuese Termoelektrana, ku kandidatēve pērveç kushteve tē pērgjithshme tē caktuara me ligj, duhet tē plotēsojnē edhe kushtet e veçanta vijuese: niveli IV, CCC-makineri, elektro, energjetik me provim tē kalur tē VKV, 1 vit pērvojē pune dhe provim profesional.
- Me datē 04.02.2020 me Vendim pēr zgjedhje tē kandidatēve pas shpalljes publike nr. 04-322/2 me datē 20.01.2020 dy Drejtorē tē filialēs REK Osllomej - Osllomej pēr realizim tē punēve nē kohē tē pacaktuar pēr ekzekutim tē vendit tē punēs 1700/81 Operatot tē kondenzimit nē shērbimin pēr Prodhim. Njēsia prodhuese Termoelektrana nē filialēn REK Osllomej – Osllomej u zgjodhēn kēto kandidatē: ..... nga inspektimi nē dokumentet e dorēzuara ēshtē vērtetuar se ..... janē teknik tē makinerisē, me pērvojēn 1 vjeçare tē punēs dhe tē gjithē i plotēsojnē kushtet e pērgjithshme dhe kushtet e veçanta tē pērcaktuara me shpalljen publike.

Nē lidhje me gjendjen faktike tē caktua, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit konstaton se dy Drejtorēt e filialēs REK Osllomej – Osllomej pēr realizimin e punēs nē kohē tē pacaktuar pēr ekzekutor nē vendin e punēs 1700/81 Operator tē kondenzimit nē Shērbimin e prodhimit, Njēsia prodhuese Termoelektrana nē filialēn REK Osllomej – Osllomej i zgjodhēn kandidatēt qē i plotēsojnē kushte e pērgjithshme dhe tē veçanat tē caktuara nē shpalljen publike pēr vendin e punēs pēr tē cilēn janē paraqitur, pērshkak tē cilēn KSHPK pērfundoi se akuzat nuk janē vērtetuar dhe nuk ka elemente pēr veprim tē mētutjeshēm pēr rastin e lēndēs, lēnda tē mbyllet dhe tē arkivohet. Duke pasē parasyshē tē theksuarēn mē lartē, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vendosi nē dispozitē tē kētij vendimi.

Punoi: m-r I.P.  
Miratoi: C.P.D., anētar i KSHPK

KOMISIONI SHTETĊORO R PĊR  
PARANDALIM TĊ KORRUPSIONIT  
Krytar: Biljana Ivanovska